



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_. 04. 2010

**V E N D I M**

**Nr. 1220 , datë 13. 04. 2010**

**Për**

**“Miratimin e dokumentit “Analize e tregut të shumicës të aksesit në Broadband si dhe të tregut të shumicës të aksesit fizik në infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU): Konsultim Publik”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës \_\_. 04. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt: “ *Miratimin e dokumentit “Analize e tregut të shumicës të aksesit në Broadband si dhe të tregut të shumicës të aksesit fizik në infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU): Konsultim Publik”*, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik të perbera nga:

- Relacioni permbledhes. (**Relacioni**);
- Dokumenti i Analizes për konsultim;
- Projekt-vendim i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485 (**Projekt-vendimi**).

**BAZA LIGJORE :**

1. Neni 31, 32, 34, 35, 36 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (*VKD*) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Rregullore për analizën e tregut, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009;
5. Udhezues për Procedurat e Keshillimit me publikun miratuar me VKD nr.1183,date 10.03.2010.

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipercituar:

### V Ë R E N :

Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit të Tregut për miratim për konsultim përbëhet nga:

1. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
2. Dokumenti “**Analize e tregut të shumicës të aksesit në Broadband si dhe të tregut të shumicës të aksesit fizik në infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU): Konsultim Publik**”, përmban analizën për FNT të tregjeve nr.14 dhe 15 të Rregullores për Analizën e Tregut, dhe detyrimet e propozuar për FNT në këto tregje.
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD;

### P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Duke marrë në konsideratë se:

Dokumenti: “*Analize e tregut të shumicës të aksesit në Broadband si dhe të tregut të shumicës të aksesit fizik në infrastrukturen e rrjetit lokal (LLU): Konsultim Publik*” si një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, KD i AKEP bazuar në pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

### V E N D O S :

1. Miratimin për konsultim publik dhe publikimin në faqen zyrtare të Internetit të AKEP të dokumentit “*Analize e tregut të shumicës të aksesit në Broadband si dhe të tregut të*

*shumices te aksesit fizik ne infrastrukturen e rrjetit local (LLU): Konsultim Publik”, bashkangjitur ketij vendimi si Aneks I.*

2. Procedura e konsultimit publik per dokumentin e analizes se tregut si dhe detyrimeve te propozuara per FNT, te cilat jane pjese e dokumentit te analizes, te kryhet, nga data 13.04/2010 deri me 12.06/2010.

Ky vendim hyn në fuqi ne daten e miratimit te tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANETARET E KESHILLIT DREJTUES:**

**1.Alketa MUKAVELATI**

**2.Benon PALOKA**

**3.Ibsen ELEZI**

**4.Zamira NURCE**